

20 qershor 2007

Komunikatë për media

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall Valën e 27-të të Privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) të mërkurën me 20 qershor, 2007 zyrtarisht shpalli valën e 27-të të Privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Menjëherë pas mbledhjes së Bordit të mbajtur më 7 qershor, AKM-ja ka njoftuar menaxhmentin e NSH-ve dhe Komunitatet përkatëse për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, ndërsa sot i ka postuar njoftimet për tender në faqen e AKM-së në internet, www.kta-kosovo.org

Në listën e tenderëve të privatizimit të valës 27 janë përfshirë 17 Ndërmarrje Shoqërore nga të cilat janë krijuar 25 Ndërmarrje të Reja.

Të gjitha Ndërmarrje Shoqërore do të privatizohen përmes spinof-it të rregullt,

Afati për parakualifikim është deri në ditën e mërkurë, 15 gusht 2007.

Data për dorëzimin e ofertave është dita e mërkurë, 22 gusht 2007.

Bashkangjitur në këtë komunikatë për media mund të gjeni listën e plotë të ndërmarrjeve:

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore në Prelez Sh.P.K. - ky tender ofron mundësinë të blej një pronë me sipërfaqe tokësore përafërsisht 100,000 m² (10ha), në një vend i cili ka potencial për zhvillim bujqësor dhe komercial. Toka e Ndërmarrjes se Re gjendet afër fshatit Prelez në veri të Ferizajt dhe afër rrugës kryesore Prishtinë- Shkup, afër fshatit Elezaj. Momentalisht gjendet kështu. Momentalisht është dhënë në shfrytëzim si livadh për kultivim sane për bagëti.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore në Varosh Sh.P.K. - ky tender ofron mundësinë të blej një pronë me sipërfaqe tokësore përafërsisht 300,000 m² (30ha), në një vend i cili ka potencial për zhvillim bujqësor dhe komercial. Toka e Ndërmarrjes se Re gjendet afër fshatit Varosh afërsisht 3km në jug të Ferizajt. Momentalisht është dhënë në shfrytëzim si livadh për kultivim sane për bagëti.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore në Komoglavë Sh.P.K. - ky tender ofron mundësinë të blej një pronë me sipërfaqe tokësore përafërsisht 150,000 m² (15ha), në një vend i cili ka potencial për zhvillim bujqësor dhe komercial. Toka e Ndërmarrjes se Re gjendet në jug të KFOR-it Grek, është në hyrjen kryesore të rrugës për në kampin Bonsteel dhe gjendet afërsisht 5km nga Ferizaj dhe ½ km nga rruga kryesore Prishtinë – Ferizaj – Shkup. Toka momentalisht kultivohet nga bujqit qiraxhinj kryesisht për grurë dhe afro 2 hektarë janë livadh.

Ndërmarrja e Re Morava e Epërme “Shtëpia e Mallrave e Vitisë” Sh.P.K. - kjo Ndërmarrje e Re është një rast shumë i mirë për blerjen e shtëpisë se mallrave se bashku me hapsiren per zyre, e vendosur në qendrën e

qytetit. Ky është një rast i veçantë komercial. Hapsira totale e shtëpisë së mallrave së bashku me zyret është përafërsisht prej 2500 m².

Ndërmarrja e Re Morava e Epërme “Trëndafilat e Vitisë” Sh.P.K. - kjo Ndërmarrje e Re është një rast shumë i mirë për blerjen e katër shitoreve të vendosura në qendrën e qytetit. Ato janë të përshtatshme për tregti apo për dhënie me qira për biznese të ndryshme. Hapësira totale e shitoreve është prej përafërsisht 650 m².

Ndërmarrja e Re Hotel Mineral Sh.P.K. - ofron mundësinë për një investim ideal në sektorin e turizmit dhe hotelerisë. Objekti mund të pranojë mysafir individual dhe ata për punë, akomodim zyreje apo salla të vogla konferencash. Oferta përfshin një parcelë toke prej afërsisht 30 ari dhe dy ndërtesa tjera të ndërlidhura. Ndërtesat përfshijnë një restorant që mund të pranojë 250 mysafir (përafërsisht 420 m²) dhe 27 dhoma me 40 shtretër.

Ndërmarrja e Re Karageva – Fabrika e vjetër e Pllakave Sh.P.K. - ofron investitorëve mundësinë të blejnë një prodhues të pllakave të qeramikës për mure dhe dysheme. Pajisjet e kësaj ndërmarrjeje janë të dëmtuara në masë të konsiderueshme. Kjo ndërmarrje është e vendosur në Kamenicë (regjioni i Gjilanit) në një sipërfaqe prej përafërsisht 7.9 ha. Halla industriale, depo dhe objekti administrativ përfshin përafërsisht 22,230 m². Furnitorët e lëndës së parë janë të vendosur në regjion.

Ndërmarrja e Re Agromorava Mulliri Elektrik Sh.P.K. - sjell një rast të mirë për të investuar në objekte të bluarjes së grurit dhe hapësira deponimi në fshatin Kabash të Vitisë. Ndërmarrja e Re do të përfshijë 12,178m² pjesërisht e zhvilluar, një mull i 2,166m² prej gjashtë kateve, (19m lartësi), një ndërtesë administrative prej afërsisht 45 m², një hangarë për deponim prej 384m² dhe një mull i vjetër prej 1,125m².

Ndërmarrja e Re Agromorava Farma e Dhive Sh.P.K. - ofron tek investitorët e interesuar një fermë dhish e cila përmban një prone prej afërsisht 0.6 ha toke dhe 3 ndërtesa të destinuara për rritjen e dhive dhe deleve. Ferma ndodhet në rrugën kryesore për Letnicë në Komunën e Vitisë.

Ndërmarrja e Re Nevolan Sh.P.K. - tokë bujqësore, me lokacion në fshatin Nevolan, komuna e Vushtrrisë, përafërsisht përfshinë 35 hektar tokë.

Ndërmarrja e Re Bukosh Sh.P.K. - tokë bujqësore, me lokacion në fshatin Bukosh, komuna e Vushtrrisë, përafërsisht përfshinë 8 hektar tokë.

Ndërmarrja e Re Vërnica Sh.P.K. - tokë bujqësore, me lokacion në fshatin Vërnice, komuna e Vushtrrisë, përafërsisht përfshinë 13 hektar tokë.

Ndërmarrja e Re Dyqanet Stan – Trg Lux Sh.P.K. - përfshinë një sipërfaqe totale prej përafërsisht 82,53 m².

Ndërmarrja e Re IMB Restorani në Mitrovicë Sh.P.K. - gjendet në qendër të Mitrovicës në katin përdhësë të ndërtesës së KEK-ut dhe përfshin një sipërfaqe prej përafërsisht 133.8 m².

Ndërmarrja e Re KB Likovci tokë bujqësore Sh.P.K. - përfshinë një sipërfaqe totale prej përafërsisht 42 ha tokë bujqësore.

Ndërmarrja e Re Dyqani Banana i Ççavicës në Vushtrri Sh.P.K. - gjendet në qendër në Vushtrri në anën e kundërt të Shtëpisë së Mallrave dhe përfshin një hapësirë dhe ndërtesë me një sipërfaqe përrreth 36 m².

Ndërmarrja e Re Fabrika e Lëkurës Bare Sh.P.K. - i ofron investuesit potencial një mundësi të shkëlqyer për të privatizuar 10649 m² (1ha 06ari 49 m²) të tokës me ndërtesë e cila ka bazën dhe katin përdhësë me sipërfaqe përafërsisht prej rreth 1600 m². Toka dhe ndërtesa janë të përshtatshme për çfarëdo lloj biznesi dhe gjenden në lokacion adekuat në fshatin Bare, në Mitrovicë.

Ndërmarrja e Re Ferma Kaçandoll - KB 23 Nëntori Sh.P.K. - përfshin një sipërfaqe të kullës rreth 9,751,500 m² (975 ha 15 are) të cilat gjenden në fshatin Kaçandoll, komuna e Mitrovicës.

Ndërmarrja e Re Virxhinia fabrika për përpunimin e duhanit Ereniku Sh.P.K. - u ofron investitorëve potencial mundësinë e blerjes së dhomave (kthinave) për tharje të duhanit dhe fabrikën e përpunimit të duhanit me makineri dhe pajisje përkrahëse të cilat gjenden brenda kufijve të NSH Virxhinia në qytetin e Gjakovës. Kërkesat për duhanin Virxhinia në tregun lokal janë të mëdha. Privatizimi i kësaj Ndër të Re është një mundësi e mirë për rifillimin e kooperimit me bujqit lokal për kultivimin e duhanit Virxhinia dhe IDGJ Duhani Sh.P.K. nga Gjilani.

Ndërmarrja e Re Bujqësia - Tokë Bujqësore Potërq Sh.P.K. - ndodhet në Komunën e Klinës. Sipërfaqja e tokës në këtë ofertë përfshin rreth 294 hektarë të tokës bujqësore që ndodhen në zonat kadastrale Potërq i ulët, Videjë, Krushevë dhe Nagllavkë të Komunës së Klinës.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Bokshiq Sh.P.K. - i ofron investitorit potencia të blejë toke bujqësore me sipërfaqe prej 200 ha. të cilat gjenden në Zonat Kadastrale Bokshiq dhe Dugajevë të Komunës së Klinës dhe në Zonën Kadastrale Gllodjan në Komunën e Pejës.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Ereniku - Baks II Sh.P.K. - mundëson prodhimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Ndërmarrja e Re përfshin sipërfaqen tokësore. Ky kompleks ka një sipërfaqe prej rreth 75 hektarësh.

Ndërmarrja e Re Rilindja Rrjeti Tregtar-Librar Zona Industriale Sh.P.K. - i ofron investitorit potencial mundësinë e fitimit të një toke shumë atraktive që gjendet në zemër të Zonës Industriale të Prishtinës. Sipërfaqja totale e tokës e cila është pjesë e këtij tenderi është 12, 331 metra katrorë.

Ndërmarrja e Re Kosova Elektro Zyret Zona Industriale Sh.P.K. – ju ofron blerësve potencial mundësi për lokale afariste (një kat) me përafërsisht 557 m² dhe oborr me një sipërfaqe përafërsisht prej 7,089 m² që gjendet në një vend kyq në zonën industriale të Prishtinës në drejtim të Fushë Kosovës.

Ndërmarrja e Re Kosova Elektro Depoja në Zonën Industriale Sh.P.K. - ju ofron blerësve potencial mundësi për lokale afariste (një kat) me përafërsisht 2000 m² dhe oborr me një sipërfaqe përafërsisht prej 4,200 m² që gjendet në zonën industriale të Prishtinës.